

Statuti dhe Akti i Themelimit
I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar
“Primo Lab” sh.p.k
Forma e Shoqerise

Neni 1

Sot, me 11.05.2021 ne themeluesit, Asfloral Haxhiu dhe Ervin Bejko kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin **“Primo Lab” sh.p.k.** Veprimtaria e saj rregullohet nga ky Statut, Akti I Themelimit dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Akti I themelimit dhe Statuti jane ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe cdo ceshtje e paparashikuar shprehimisht ne to, rregullohet sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Themeluesit e shoqerise jane:

1. Asfloral Haxhiu, shtetas shqiptar, i datelindjes 14.01.1989 lindur banues ne Lushnje, madhor me zotesi te plate juridike per te vepruar, mbajtes i kartes ID me nr. 034077246 dhe nr. personal I90114083J
2. Ervin Bejko, shtetas shqiptar, i datelindjes 14.08.1978 lindur ne Kucove dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plate juridike per te vepruar, mbajtes i kartes ID me nr. 036242246 dhe nr. personal H80814035J.

Qendra e Shoqerise

Neni 2

Selia e Shoqërisë **“PRIMO LAB” sh.p.k.** ndodhet ne adresën: Qarku Fier, Bashkia Lushnje, Lagjja “Xhevdet Nepravishta”, Rruga Rrahman Ruci, prane Spitalit Lushnje, Nr pasurie 25/203 Zona kadastrale 8571. Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë vendin.

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte e pakufizuar.

Objekti I veprimtarise se shoqerise

Neni 4

Objekti I veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

Qender mjeksore, sherbim mjeksor pediatrik, ORL, kardiologji, obsetrik-gjinekologji, kardiologji, radiologjik etj. Laborator klinik, biokimik, mikrobiologjik, gjenetik, etj. Qender kurative mjekesore, trajtimi i mjeteve te transportit per kujdesin shendetesor, import eksport me shumice e pakice depo farmaceutike dhe farmaci, aparatura dentare dhe aksesoret e tyre, trajnim, servis, mirembajtje, profilaksi te te gjithë aparaturave mjekesore, per laboratore kimike, biologjike, transport mallrash e pasagjeresh. Blerje dhe shitje pajisje mjekesore, blerje dhe shitje kile, reagente, materiale mjekesore. Sherbim



konsulence mjekesore dhe te ndryshme, ofrime sherbime laboratorike dhe mjekesore. Blerje dhe shitje barnash, integratore, materiale kozmetike, materiale te ndryshme para farmaceutike , farmaceutike, mjekesore .

Neni 5

Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortakë, te rrisë kapitalin sipas vendimeve te asamblese se ortakëve.

Kapitali I shoqerise

Neni 6

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100 000 (Njeqindmije) Leke .

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme qe nenkuptohet i perbere nga 2 (dy) kuote me vlere te pergjithshme prej 100 000 leke. Kjo kuote i perket ortakëve si me poshte:

1.Asfloral Haxhiu zoterues e 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 50 000 leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

2.Ervin Bejko zoterues e 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 50.000 leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te ortakëve.

Drejtimi dhe administrimi

Neni 7

Shoqeria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 8

Ortaku i shoqerise me krijimin e kesaj shoqerie pjesen e kapitalit te derdhur prej tij nuk mund ta terheqin. Kjo mund te behet vetem pasi te nxirret bilanci I shoqerise per fitimin e realizuar.

Neni 9

Emertimi I shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emrat e administratoreve si dhe emrat e ortakëve duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

Neni 10

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashte kontraktore. Ortaket e shoqerise drejtojne procesin per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise si dhe per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te treteve pa asnjë kufizim.



Kompetencat e ortakeve

Neni 11

Per menyren e drejtimimit dhe ushtrimimit te aktivitetit te shoqerise, ortaku shprehet me vendime per gjithshka qe eshte ne kompetencat e tyre te pershkruara si me poshte:
Kane te drejte te bejne ndryshime ne statut.
Kane te drejte te miratojne bilancin e shoqerise dhe te bejne ndarjen e fitimit.
Ata emerojne administratoret, zevendesit, ekspertet dhe revizoret kontabel.
Ata aprovojne cdo lloj veprimi financiar qe me ligj dhe me marreveshje lihet ne kompetencat e tyre
Miratojne zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit
Percaktojne shperblimin per administratorin, ekspertet, revizoret kontabel.
Bejne transferimin e kuotave te te tretet
Bejne lidhjen e kontratave per dhenie dhe marrje te drejtash ose ekskluzivitet per tregtimin dhe prodhimin e mallrave te shoqerise si dhe kontrata ne lidhje me organet shtetore per pjesmarrjen ne tender ankande ose aktivitete te tjera te rendesishme
Realizojne blerje, shitje si dhe tjetersim te pasurive te paluajtshme te shoqerise.
Kane te drejte te bejne modifikimin e kontrates se shoqerise, etj.

Neni 12

Kompetencat e ortakeve, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

Administrimi

Neni 13

Administrator i shoqerise eshte Ervin Bejko, shtetas shqiptar, e datelindjes 14.08.1978 lindur ne Kucove dhe banues ne Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e kartes ID nr. 036242246 dhe nr. personal H80814035J.
Afati i mandatit eshte 5 (pese) vjet.

Neni 14

Administratori mund te emeroje nje ose me shume administrator te deleguar ose perfaqesues te thjeshte per te kryer veprime te vecanta duke percaktuar fuqine e tyre brenda kufijve e duke respektuar statutin dhe ligjet ne fuqi. Detyrat e tyre do te percaktohen ne nje regullore te brendshme te shoqerise.

Neni 15

Administratori ka liri te plote per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marreveshje per realizimin e qellimeve te shoqerise duke perjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe Statut qe I takojne ortakeve. Raporti I administrimit, inventari dhe llogarite vjetore hartohen nga Administratori.



Marredheniet e punes

Neni 16

Marredheniet e punes regullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektojne rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendeshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe I shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Konfidencialiteti, ruajtja e sekretit

Neni 17

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratori I shoqerise.

Ekspertet ose revizoret kontabel

Neni 18

Kontrolli mbi veprimtarine e shoqerise si dhe gjithë aktivitetin e shoqerise I besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Ortaket caktojne dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

Viti financiar, bilanci vjetor, shperndarja e fitimeve

Neni 19

Viti financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit. Viti I pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne QKR dhe perfundon me 31 dhjetor te te njejt vit.

Miratimi I dokumenteve qe lidhen me vitin financiar duhet te behen brenda 6 muajve qe nga fundi I vitit financiar.

Bilanci dhe fitimet

Neni 20

Veprimtaria ekonomike do te mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit ,rezultatit ekonomik fitim-humbje dhe inventarit. Pasi vecohen fondet si me siper paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten I kalojne ortakeve te shoqerise.

Neni 21

Ne rast se kapitali I shoqerise per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, ortaket vendosin brenda 4 muajve mundesine e prishjes se jashtezakonshme te shoqerise.



Shperndarja dhe likuidimi i shoqerise
Neni 22

Ne rast se shoqeria shperndahet per cdo lloj arsye asambleja e ortakeve percakton menyren e likuidimit, emeron nje ose me teper likuidator dhe pergatit te gjitha dokumentat e nevojshme per cregjistrimin e saj nga regjistri tregtar.

Librat e shoqerise
Neni 23

Po keshtu shoqeria ne baze te ligjit mban librat e meposhtem:

1-libri i ortakeve

2-libri i mbledhjeve

3-libri i vendimeve te administratorit

4-libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabel

Librat e mesiperme duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jete e vulosur.

Dispozita te pergjitheshme
Neni 24

Per sa esht shprehur ne kete statut i referohemi Ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Ligjit 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", Statutit dhe regullores se brendshme te shoqerise. Cdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre ky statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

Ortaket e
Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar

"PRIMO LAB" sh.p.k.

Ervin Bejko



Asfloral Haxhiu



Lushnje me, 11.05.2021